



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS - SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL
PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA
IZBORNI PANEL ZA ŽALBE I PREDSTAVKE - ELECTION COMPLAINTS AND APPEALS PANEL

ZL.Anr.436/2025

PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët Skender Çoçaj kryesues, Arsim Hamzaj dhe Kymete Kicaj anëtarë, duke vendosur lidhur me ankesën e Adenis Ahmeti, Komisioner i Vendvotimit nga subjekti politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me seli në Prishtinë dega Fushë Kosovë, paraqitur kundër Fatmir Bllaca Kryesues i Vendvotimit nga radhët e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, dega Fushë Kosovë, lidhur me parregullsitë/shkeljet gjatë ditës së votimit, të Zgjedhjeve Lokale në Republikën e Kosovës, për Raundin e dyte për Kryetar të Komunës, të mbajtura me datën 09 Nëntor 2025, në seancën e panelit të mbajtur, më datë 12.11.2025, merr këtë,

V E N D I M

REFUZOHET E PABAZUAR ankesa ZL.Anr.436/2025, e datës 11.11.2025, e parashtruar nga Adenis Ahmeti komisioner i Vendvotimit nga subjekti politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me seli në Prishtinë dega Fushë Kosovë, paraqitur kundër Fatmir Bllaca Kryesuesi i Vendvotimit nga radhët e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, dega Fushë Kosovë, lidhur me parregullsitë/shkeljet gjatë ditës së votimit, të Zgjedhjeve Lokale në Republikën e Kosovës, për Raundin e dyte për Kryetar të Komunës, të mbajtura me datën 09 Nëntor 2025.

A r s y e t i m

Më datë 11.11.2025, PZAP-i ka pranuar ankesën ZL.Anr.436/2025, nga Adenis Ahmeti komisioner i Vendvotimit nga subjekti politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), në të cilën thekson se gjatë ushtrimit të detyrave të mija si komisioner, rreth orës 16:00. kam hasur një fletëvotim të dyshuar si të pavlefshëm/fals. Sipas procedurave të KQZ-së, unë e kam raportuar menjëherë te kryesuesi i vendvotimit z. Fatmir Bllaca nga subjekti Vetëvendosje. Pas raportimit tim, kryesuesi nuk e ka regjistruar incidentin, nuk e ka raportuar te KZP as te KQZ, ka vepruar duke e shqyer fletëvotimin dhe e ka hedhur në mbeturina, duke e shkatërruar. Parashtruesi i ankesës tutje thekson se ky veprim përbën shkelje të rëndë të Rregullores së KQZ-së për materialin zgjedhor, në Komunën Fushë Kosove, udhëzimeve për evidentim të parregullsive, detyrave zyrtare të kryesuesit të vendvotimit, obligimeve për ruajtjen e integritetit të materialeve zgjedhore, veprimet e mia si komisioner. Parashtruesi po ashtu thekson se pasi kryesuesi nuk ndërmori asnjë veprim dhe shkatërroi materialin zgjedhor ndërmora përpjekje ta raportoj rastin, me qëllim që rasti të dokumentohet dhe të merren masat përkatëse.

Në përgjigjen në ankesë KQZ-ja, sqaron se bazuar në nenin 6 të Rregullores Zgjedhore Nr. 12/2024 për Votimin, Numërimin në Vendvotim dhe Menaxhimin e Vendvotimit përcaktohet në mënyrë të detajuar mbarëvajtja dhe ecuria, obligimet në vendvotim. Gjatë procesit të verifikimit dhe numërimit vlejné procedurat e numërimit në VV, sipas Rregullores Zgjedhore Nr.12/2024 Votimi, Numërimi në Vendvotim dhe Menaxhimi i Vendvotimit. Andaj, bazuar në Rregullën Zgjedhore Nr.13/2024 Rezultatet e Zgjedhore nenin 9 paragrafi 1 thekson se: Në rast të mospërputhjes së rezultateve, KQZ-ja mund të urdhëroj rinumërimin e votave të cilit do VV, ose edhe përsëritjen e votimit në një VV apo QV. Në kuptim të nenit 117 paragrafi 3 të LZP, gjatë shqyrtimit të ankesës është vërejtur se pala ankuese, nuk ka bashkëngjitur prova relevante, siç janë; Numri i Qendrës së votimit dhe vendvotimi ku ai ka qenë anëtar i KVV-së dhe libri i votimit, që do të mund të dëshmonin apo mbështesnin pretendimet tij.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa - PZAP, pas shqyrtimit të ankesës dhe shkresave të lëndës konstaton se:

Ankesa është e pabazuar

Paneli, pas shqyrtimit të shkresave të lëndës dhe përgjigjes në ankesë të paraqitur nga KQZ-ja, vlerësoi se pretendimet e komisionerit të Vendvotimit Adenis Ahmeti nga subjekti politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), janë të pabazuara. Pretendimet ankimore të komisionerit të Vendvotimit nga subjekti politik (PDK), se gjatë ushtrimit të detyrave të tij si komisioner, rreth orës 16:00 ka hasur një fletëvotim të dyshuar si të pavlefshëm/fals, dhe sipas procedurave të KQZ-së, e ka raportuar menjëherë te kryesuesi i vendvotimit z. Fatmir Billaca nga subjekti Vetëvendosje, dhe pas raportimit, kryesuesi nuk e ka regjistruar incidentin, nuk e ka raportuar te KZP as të KQZ, ka vepruar duke e shqyer fletëvotimin dhe e ka hedhur në mbeturina, duke e shkatërruar, PZAP-i vlerësoi si të pabazuara, pasi që pas shqyrtimit të ankesës konstatohet se parashtruesi nuk ka bashkëngjitur asnjë provë materiale apo dëshmi mbështetëse që do të vërtetonte pretendimet e ngritura, që do të mund të dëshmonte ekzistencën e incidentit të pretenduar ose veprimin e kryesuesit të vendvotimit, kjo për faktin se një incident i tillë është dashur që të evidentohet në librin e votimit nga vet komisioneri në fjalë dhe të ofroj dëshmi në PZAP se a është evidentuar incidenti në librin e votimit nga vet parashtruesi i ankesës si komisioner i vendvotimit.

Në mungesë të provave të tilla, pretendimet e parashtruesit mbesin në nivel deklarativ dhe nuk plotësojnë standardin minimal të provueshmërisë së kërkuar për të konstatuar një shkelje të tillë. Për rrjedhojë, ankesa refuzohet si e pabazuar, pasi që parashtruesi nuk ka ofruar asnjë provë konkrete për të mbështetur pretendimin për shkelje të procedurave të administrimit të materialit zgjedhor.

Duke marrë parasysh të lartpërmendurat, Paneli vlerëson se parashtruesi i ankesës në mbështetje të pretendimeve të tij, nuk ka ofruar dëshmi të qarta dhe bindëse, edhe pse në bazë të nenit 117 paragrafi 3 të Ligjit Nr.08/L-228 Për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, barra e të provuarit bie mbi ankuesin, në të cilin nen përcaktohet se “Vendosja për ankesat nga PZAP-ja mbështetet në dëshmi të qarta dhe bindëse”.

Nga arsyet e theksuar më lartë duke u bazuar në nenin 117 paragrafi 3, neni 118 paragrafi 1 të LZP-së, paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA
ZL.Anr.436/2025 më datën 12.11.2025

Kryesues i Panelit
Skender Çoçaj



Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 paragrafi 4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda dyzet e tetë (48) orëve nga momenti i marrjes-pranimi të këtij vendimi.